



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 770/2 Prot.

Tiranë, më 28. 09. 2017

V E N D I M

Nr. 100, Datë 28. 09. 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. 68, datë 03.08.2017, të paraqitur nga subjekti ankues K. O., me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të racës* ¹”, nga ana e Bashkisë së Fierit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

K. O. pretendon se: *“Jetoj në kushte të vështira jetese, shtëpinë e kam në gjendje të rrënuar. Kam vajtur në bashki për këtë problem, por nuk më kanë dhënë përgjigje. Kërkoj nga bashkia të më ndihmojë për problemin e strehimit”*. Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Bashkia Fier t'i bëhet rikonstruktion banesës së tij.

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

¹ K. O. shprehet se i përket komunitetit rom.

1. Me anë të shkresës me Nr. 758/1 Prot., datë 14.08.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Fier, lidhur me ankesën bërë nga K. O., për pajisjen me banesë.

Me shkresën me Nr. 6562/1 Prot., datë 04.09.2017, nga ana e Bashkisë Fier, sqarohet se “... pasi janë bërë verifikimet përkatëse, rezulton se në emër të këtyre shtetasve² nuk ka asnjë kërkesë/ ankesë/ shkresë zyrtare drejtuar Bashkisë Fier. Po kështu, ju informojmë se të gjitha familjet të cilat aplikojnë për t’u regjistruar si familje të pastreha, për t’u seleksionuar si aplikime të vlefshme për t’u trajtuar më pas nga programet sociale të strehimit (sipas programeve konkrete që ka Bashkia Fier) kanë detyrim ligjor të plotësojnë dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin administrativo-ligjor sipas kërkesave që parashikon Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij. Sikurse familjet e pastreha, kanë detyrimin e respektimit dhe zbatimit të ligjit (për të aplikuar dhe regjistruar si të pastreha) dhe ne si institucion, kemi detyrimin ligjor të zbatimit të drejtë të procedurave dhe vlerësimit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore që ai parashikon për programet sociale të strehimit, duke i dhënë përparësinë që parashikon ligji për anëtarët e komuniteteve të ndryshme në nevojë, siç mund të jetë komuniteti rom apo egjiptian. Në këto kushte, qytetarët D. O., S. K., B. O., K. O. dhe L. M., duhet të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Ligjin Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar), si dhe VKM nr. 574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”. Bëjmë me dije se çdo rast emergjent, pas verifikimit të gjithë dokumentacionit të rregullt ligjor të depozituar në rrugë zyrtare pranë Bashkisë Fier, do të trajtohet me përparësi brenda hapsirave ligjore, për çdo program social strehimi, që mund të disponohet nga ana e institucionit tonë.”

Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri vlerëson se:

Bazuar në përgjigjen shkresore sa më sipër, nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e Bashkisë Fier, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk është paraqitur pranë njësisë vendore ku figuron i regjistruar, për të aplikuar për përfitimin nga programet sociale të strehimit, duke plotësuar fillimisht dokumentacionin përkatës të strehimit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gerrat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminit për shkak të racës, ndaj K. O., nga ana e Bashkisë Fier.

² Pasi kërkesa për informacion i është drejtuar Bashkisë Fier për 5 ankues njëkohësisht.

2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të përfitojë nga Programet Sociale të Strehimit që disponon Bashkia Fier, të paraqitet pranë kësaj njësie vendore, për të plotësuar fillimisht formularin tip të strehimit, dhe më pas për të depozituar dokumentacionin e kërkuar prej tyre.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)